



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

PAKETA LIGJORE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NDAJ TË TRETËVE NGA UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) është institucion i arsimit të lartë. Si i tillë, UPT ushtron veprimtarinë e tij institucionale mbështetur në ligjin. nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

- Në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, institucionet publike të arsimit të lartë gëzojnë autonomi financiare e cila garantohet nëpërmjet të drejtës për të krijuar të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë e mësimdhënies, nga veprimtaritë kërkimore – shkencore, nga të drejtat intelektuale, nga markat dhe patentat, nga shërbimet si dhe nga veprimtari të tjera ekonomike.

E drejta e institucioneve të arsimit të lartë për të krijuar të ardhura dhe për të ofruar shërbime të specializuara në përmbushje të misionit të tyre, është e përcaktuar shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, dhe konkretisht neni 3, pika 3 gërma a, neni 18 pika 4, neni 59 pika 1, neni 95 pika, 5 neni 109, pika 1, gërma c dhe pika 2, në aktet nënligjore në zbatim të tij si dhe në Statutin e UPT nenin 3 pika 3, nenin 10, pika 2 gërma e, nenin 24, pika 1 gërma a, nenin 25, pika 1, gërma j etj.

- Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT) krijon të ardhura të ligjshme nga veprimtaritë kërkimore – shkencore, nga të drejtat intelektuale, si dhe nga shërbimet për ofrimin e të cilave i është dhënë e drejta me akte ligjore dhe nën ligjore të posaçme.

Në këtë kontekst, UPT që prej vitit 2010 realizon shërbimet e oponencave teknike. Ky shërbim realizohet në mbështetje të ligjit Nr. 8402 dt.10/09/1998: “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, Neni 6, V.K.M. Nr. 1055 datë 22/12/2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit me objekte me vlerë mbi 100 milionë”, V.K.M Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim” dhe Urdhrit të Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit Nr. 197, Date 09. 10. 2014, “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit`.

Sipas V.K.M. Nr. 1055 datë 22/12/2010, pika 2, për të gjitha projektet e veprave të ndërtimit, oponenca teknike do të bëhet nga subjekte publike studimore/shkencore, të miratuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit.

Vlerat e oponencave teknike përlogariten sipas aneksit të këtij akti, ku thuhet se tarifat për oponencën teknike për projektet e veprave të ndërtimit, i referohen tarifës në përqindje të vlerës së projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të punimeve ...

Për përlogaritjen e të vlerës së projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit i referohemi legjislacionit në fuqi dhe konkretisht V.K.M Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim”.

Sipas Urdhrit të Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit Nr. 197, Date 09. 10. 2014, pika 1, oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit, të kryhet nga Instituti i Ndërtimit për të gjitha objektet publike që pajisen me leje zhvillimore ndërtimi, infrastrukture dhe komplekse, sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

Po këtu, sipas pikës 2, oponenca teknike për projektet e veprave të ndërtimit, për objekte që nuk janë të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhëri, të kryhet nga Instituti i Ndërtimit dhe Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit.

Mbështetur në legjislacionin më sipër cituar, Universiteti Politeknik i Tiranës ka lidhur dhe realizuar një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi për kryejën e oponencave teknike të veprave të ndërtimit, të cilat deri në datë 20.06.2019 janë realizuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit i UPT.

Duke nisur prej kësaj date dhe në vijim, oponencat teknike janë kryer në nivel institucioni, mbështetur në Urdhërin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë Nr. 243, datë 12.06.2019 “Për një ndryshim në Urdhërin Nr.197, datë 09.10.2014 të Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit “Për miratimin e kushteve të përgjithshme të marrëveshjes për kryerjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

Referuar Urdhërit më sipër cituar, pika 1 a, citojmë:

“Për të gjitha projektet (objektet) publike të veprave të ndërtimit, për të cilat kryerja e oponencës teknike është e detyrueshme sipas legjislacionit në fuqi, oponenca teknike të kryhet nga Instituti i Ndërtimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.”

- Krahas shërbimeve të oponencave teknike të veprave të ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës kryen edhe shërbime në fushën e projektimit, realizimi i të cilave mbështetet në **Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 188, datë 13.03.2019 “Për ofrimin nga institucionet publike të arsimit të lartë të shërbimeve, në përputhje me veprimtarinë e tyre, për institucionet e qeverisjes qendrore dhe institucionet në varësi të tyre”.**

Bazuar në vendimin e sipërcituar, kryeministria, ministritë e linjës, institucionet e qeverisjes qendrore apo institucionet e varësisë së tyre, kanë detyrimin të kërkojnë fillimisht, sipas nevojave, shërbime me fonde buxhetore si konsulenca, studime apo ekspertiza nga institucionet publike të arsimit të lartë, sipas fushave të veprimit.

Ndërkohë gjitha institucionet e pavaruara të shtetit, kanë të drejtë të kërkojnë kryerjen e këtyre shërbimeve, nga institucionet publike të arsimit të lartë.

Referuar aktit më sipër cituar, përlllogaritja e vlerës së shërbimeve, kryhet sipas tarifave të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi, ose në mungesë të tyre, të miratuara me akte të brendshme nga Bordi i Administrimit i UPT, mbështetur në vlerat mesatare të tregut

Tarifat për shërbimet në fushën e projektimit përlllogariten sipas V.K.M Nr.354, dt.11/05/2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projekte, mbikqyrje dhe kolaudim”.

- Shërbimet në fushën e planifikimit të territorit, projektimit, mbikqyrjes dhe kolaudimit, ku përfshihen, por nuk kufizohen në: hartime projektesh, raportesh, relacionesh teknike, apo çdo formë tjetër konsulence në fushën e projektimit, të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi, kryhen në respektim të legjislacionit në fuqi në fushën ndërtimore, si dhe manualat teknike, normativat dhe standardet shtetërore dhe ndërkombëtare, për këtë tipologji shërbimi.

Konkretisht aktet ligjore, në bazë të të cilave realizohen shërbimet në fushën e projektimit nga UPT, sikurse të gjithë subjektet projektuese në Republikën e Shqipërisë, janë:

- Ligji nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.
- VKM nr. 26 datë 15.01.2020 “Për kryerjen e aktekspertizës së thëlluar në ndërtesat e dëmtuara”.
- VKM Nr. 686 datë 22.11.2017 “Rregullorja e planifikimit të territorit”.
- VKM Nr. 408 datë 13.05.2013 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”
- VKM-së nr.354 datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.
- Etj.